



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000383/7

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasit S.S.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

Për dijjeni: Z. S.S.
Lagjja 14, Rr. "Klaudio Vila"

Durrës

I nderuar z. Veliu,

Me shkresat nr. K2/S41-3 prot., datë 24.12.2019 dhe nr. K2/S41-2 prot., datë 18.09.2020 ju kemi vënë në dijeni se në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi S.S.. Ankuesi shkruan se ka fituar të drejtën për të vazhduar Akademinë e Sigurisë si student i ekselencës, por më pas është skualifikuar. Sipas tij, shkak për skualifikimin është bërë vërtetimi negativ i besueshmërisë nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës. Ky vërtetim është dhënë negativ me arsyetimin se në vitin 1991 ka ndodhur një ngjarje në të cilën është përfshirë babai i tij, i cili ka vepruar në rrethanat e mbrojtjes së nevojshme, por nuk është dënuar penalisht. Ankuesi pretendon se skualifikimi i tij për këtë shkak është i pa bazuar në ligj sepse babai i tij nuk është dënuar me burgim apo me ndonjë dënim tjetër penal të formës së prerë, si për ngjarjen e ndodhur me të në vitin 1991 ashtu edhe për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale gjatë gjithë jetës së tij. Gjithashtu ankuesi pretendon se për këtë padrejtësi, ka bërë një ankesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit por nuk i është zgjidhur problemi.

Ju me shkresën nr.4/S-10 prot., datë 23.09.2020 ndërmjet të tjerave na informuat se shtetasi S.S. ka aplikuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Durrës për t'u pranuar në Policinë e Shtetit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit, ai është shpallur fitues pasi plotësonte kriteret e veçanta si dhe ka rezultuar fitues edhe në fazat e tjera të vlerësimit dhe kontrollit (testin e gjuhës angleze, intervistën me gojë, kontrollin shëndetësor dhe verifikimin e gjurmëve të gishtave).

Pavarësisht sa më sipër, sipas nenit 39 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe neneve 135 dhe 139 të “Rregullores së Policisë së Shtetit”, miratuar me VKM nr. 750, datë 19.09.2015, faza e fundit e verifikimit të aplikantëve për pranimin në Akademinë e Sigurisë është ajo e verifikimit përfundimtar (*Vërtetimi i besueshmërisë*).

Po ashtu, na vini në dijeni se me shkresën nr. 1816/1, datë 07.03.2019 DVP Durrës ka dërguar vërtetimin e besueshmërisë për shtetasin S.S. në të cilin konstatohen probleme të cilat pengojnë pranimin e tij në Polici pasi ka pjesëtarë të familjes (babain) të implikuar në veprimtari kriminale. (*Në vitin 1990, babai i shtetasit S.S. ka kryer veprën penale të vrasjes, por nuk është dënuar për këtë veprë penale. Policia nuk disponon dokumentacion në lidhje me pafajësinë apo pushimin e çështjes penale ndaj tij*).

Me qëllim riverifikimin e këtij shtetasi, i është kërkuar DVP Durrës që të bëjë rivlerësimi i vërtetimit të besueshmërisë dhe me shkresën nr. 1972/1, datë 13.03.2019, DVP Durrës ka rikonfirmuar faktin e mësipërm.

Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit me vendimin nr. 14, datë 13.03.2019, ka vendosur skualifikimin e shtetasit S.S..

Për shkak të natyrës së punës në Policinë e Shtetit, është në kompetencën e këtij institucioni që të përzgjedhë dhe të pranojë në polici, kandidatët më të përshtatshëm sipas kriteve të përcaktuara në ligj dhe të njohura nga kandidati në momentin e aplikimit. Ky fakt nuk përbën në parim diskriminim për kandidatët e skualifikuar.

Përveç sa më sipër u informuam se shtetasit S.S. i është komunikuar vendimi i Komisionit të Vlerësimit për skualifikim, si dhe i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 243/1, datë 10.01.2020.

Ndërsa Komisariati i Policisë Durrës me shkresën nr. 7184/1 prot., datë 29.09.2020 ndërmjet të tjerave na informoi se nga ky institucion është përpiluar vërtetimi i personalitetit të shtetasit S.S.. Gjatë procesit të verifikimit janë njohur me një informacion se rreth vitit 1990 babai i shtetasit S.S. është përfshirë në një ngjarje, ka vrarë burrin e motrës së tij, shtetasin S.K., në fshatin Gradishtë, Lushnjë. Sipas informacionit shtetasi M.S. është arrestuar dhe ka qëndruar për një periudhë kohë në paraburgim. Pretendohet prej tij se kjo çështje është pushuar pasi ngjarja është kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, por as vetë ai nuk disponon dokumentacion ku të vërtetohet ky fakt.

Për sa më sipër, bazuar në Urdhrin nr. 417, datë 02.05.2018 “Për formën dhe përmbajtjen e vërtetimit të besueshmërisë” është përpiluar vërtetimi i besueshmërisë për shtetasin S.S., ku duhet të përfshihen edhe informacionet për përfshirje në veprimtari kriminale të personave në përbërje të Certifikatës Familjare, jo vetëm të subjektit të drejtëpërdrejtë. Për këto arsye ky institucion ka dhënë mendimin se shtetasi S.S. nuk i plotëson kushtet për t’u pranuar si kandidat në Akademinë e Sigurisë, duke qenë se mund të jetë në marrëdhënie konfliktuale apo hasmërie me familjen e viktimës.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të dërguar nga ankuesi dhe i përgjigjeve të dërguara institucionit tonë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si dhe DVP

Durrës me shkresat e cituara me sipër rezulton se, bazuar në nenet 37 dhe 38¹, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”; Urdhrin nr. 144, datë 31.01.2019, të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e kriterëve të veçanta për pranimin në Policinë e Shtetit të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të Arsimit të Lartë”; Urdhrin nr. 138/1, datë 12.02.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Policinë e Shtetit të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të Arsimit të Lartë”; Urdhrin nr. 138, datë 31.01.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, që ka miratuar “Procedurat e vlerësimit për pranimin në Policinë e Shtetit, të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të Arsimit të Lartë”, shtetasi S.S., i cili zotëronte Diplomën “Master i Shkencave në Menaxhim Bankar”, lëshuar nga një institucion arsimor privat dhe plotësonte kriteret e ligjore, në vitin 2019 ka konkuruar për të studiuar pranë Akademisë së Sigurisë.

Në nenin 135, të Rregullores për Policinë e Shtetit, miratuar me Vendimin nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, përcaktohen të gjitha fazat e konkurimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë. Neni i sipërcituar parashikon se:

“1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurimit sipas rendit të mëposhtëm:

- a) testimit me shkrim;*
- b) testimit të aftësive fizike;*
- c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të të shkruarit;*
- ç) testimit psikologjik;*
- d) kontrollit shëndetësor;*
- dh) marrjes së shenjave të gishtave;*
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit.*

2. Drejtori i Policisë së Shtetit përcakton rregullat e testimit, kufirin minimal të pikëve, si dhe peshën specifike që do të ketë secili prej testeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në raport me rezultatin e përgjithshëm të aplikantit.”

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se shtetasi S.S. ka kaluar me sukses të gjitha fazat e konkurimit për në Akademinë e Sigurisë, duke mbërritur në fazën e verifikimit përfundimtar. Në nenin 139, të Rregullores për Policinë e Shtetit miratuar me Vendimin nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, parashikohet shprehimisht se:

“1. Aplikanti që kalon me sukses procesin e testimit të përcaktuar në nenin 135, germa “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj rregulloreje, i nënshtrohet procesit të

¹ Kriteret për pranimin në Akademinë e Policisë

1. Pranimi në Akademinë e Policisë bëhet nëpërmjet konkurimit të hapur.

2. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;*
- b) të mos jetë i përjashtuar nga policia apo të jetë larguar nga shërbimi civil;*
- c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;*
- d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm;*
- dh) të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;*
- e) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;*
- ë) të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B.*

verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin që ai, ose pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale.

2. Numri i aplikantëve që do t'i nënshtrohen procesit të verifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është i njëjtë me kuotën për konkurrim të përcaktuar në fillim të procesit.

3. Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës.

4. Verifikimi kryhet nga strukturat vendore dhe qendrore të hetimit të krimit, sipas procedurave të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

5. Relacioni (lidhja 17) me dokumentacionin e çdo aplikanti fitues, i dërgohet Akademisë së Sigurisë.”

Mbështetur në parashikimin e pikës 4, të nenit të mësipërm, DVP Durrës ka kryer verifikimet përkatëse mbi shtetasin S.S. , nëse ai apo pjesëtarë të familjes së tij janë të implikuar në veprimtari kriminale. Personat e ngarkuar për kryerjen e verifikimeve përkatëse pranë DVP Durrës kanë hartuar edhe vërtetimin e besueshmërisë. Referuar shkresës tuaj nr. 4/S-10, datë 23.09.2020 rezulton se DVP Durrës me shkresën nr. 1816/1, datë 07.03.2019 i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit vërtetimin e besueshmërisë për ankuesin.

Ju na informuat se ky vërtetim për shtetasin S.S. ishte negativ, pasi janë konstatuar probleme, të cilat pengonin pranimin e tij në Polici, pasi ankuesi ka pjesëtarë të familjes (babain) të implikuar në veprimtari kriminale. Sipas shkresës në fjalë, rreth vitit 1990, babai i shtetasit S.S. ka kryer veprën penale të vrasjes, por nuk është dënuar për këtë vepër. Policia nuk disponon dokumentacion në lidhje me pafajsinë apo pushimin e çështjes penale ndaj tij².

Me qëllim verifikimin e këtij shtetasi, i është kërkuar DVP Durrës që të bëjë rivlerësimi i vërtetimit të besueshmërisë dhe me shkresën nr. 1972/1, datë 13.03.2019, DVP Durrës rikonfirmon faktin e mësipërm. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit me vendimin nr. 14, datë 13.03.2019, ka vendosur skualifikimin e shtetasit S.S..

Shtetasi S.S. ka depozituar ankesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ky institucion i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 243-S/1, datë 21.03.2019, ku e informoni se, pas përfundimit të procesit të verifikimit përfundimtar, pavarësisht dëshirës dhe interesit reciprok që të bëhet pjesë e strukturave tuaja, bazuar në të dhënat që dispononi aktualisht dhe referuar kriterëve të përcaktuara në nenin 139 të Rregullores së Policisë, ai nuk rezulton të jetë kandidat i përshtatshëm për t'u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit”.

Nga dokumentacioni i administruar nga ana jonë gjatë hetimit administrativ të kësaj ankese dhe konkretisht, shkresa nr. M-107/1 prot., datë 22.05.2019 e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme; shkresa nr. 136/1 prot., datë 06.02.2020 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë; shkresa nr. 6177/1 prot., datë 01.07.2020 e Sektorit të Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rezulton se shtetasi M.S., i ati i ankuesit, është i pa dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu rezulton se për ngjarjen e ndodhur

² Referuar citimit të shkresës nr. 4-S/4, datë 18.02.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

në vitin 1991, ndaj tij nuk është regjistruar ndonjë kallëzim dhe nuk disponohet ndonjë informacion.

Informacioni i administruar nga strukturat vendore të policisë Durrës se në vitin 1990, shtetasi M.S. ka vrarë kunatin e tij, për një konflikt pronësie në kushtet e mbrojtjes së nevojshme³, i cili ka qenë shkaku i vetëm për skualifikimin e ankuesit nga Akademia e Sigurisë, nuk është dhe nuk duhet të jetë e dhënë apo provë për mosplotësimin e kritereve ligjore nga ana e tij për të qënë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit. Sikurse parashikohet në mënyrë të qartë në nenin 19 të Kodit Penal, personi që kryen një veprë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme nuk ka përgjegjësi penale.

Në nenin 30, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet shprehimisht: *“Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”*.

Në këtë kontekst, arsyetimi i përdorur në përgjigjen tuaj se: *“Në vitin 1990, babai i shtetasit S.S. ka kryer veprën penale të vrasjes, por nuk është dënuar për këtë veprë penale. Policia nuk disponon dokumentacion në lidhje me pafajësinë apo pushimin e çështjes penale ndaj tij”*, nuk është argument ligjor për të skualifikuar ankuesin nga Akademia e Sigurisë. Në rrethanat kur në ngarkim të babait të ankuesit, shtetasit M.S., nuk është dhënë nga gjykata kompetente asnjë vendim penal i formës së prerë ai konsiderohet i pafajshëm.

Referuar doktrinës juridiko-penale, termi “veprimtari kriminale” përkufizohet në kuptimin e tij të ngushtë dhe në kuptimin e tij të gjerë. Në kuptim të ngushtë, veprimtaria kriminale nënkupton kryerjen e një ose disa krimeve ose veprave penale. Në kuptimin e gjerë ose atë kriminologjik dhe sociologjik, ky term nënkupton kryerjen e disa veprave penale, në mënyrë të organizuar, të paramenduar dhe të planifikuar në fusha të ndryshme, të tilla si fushën e trafikimit të narkotikëve, qënieve njerëzore, vjedhjes, etj. Referuar interpretimit në kuptim të ngushtë apo edhe të gjerë të termit të mësipërm, shtetasi M.S., babai i ankuesit S.S., në asnjë rast nuk mund të akuzohet apo të pretendohet se është i përfshirë në veprimtari kriminale.

Gjithashtu shtetasi M.S. nuk rezulton se bën pjesë apo është i implikuar në veprimtarinë e organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura, dhe as në grupe të strukturuar kriminale, në kuptim të nenit 28 të Kodit Penal. Ai nuk rezulton të ketë qenë dhe nuk është i dënuar penalisht nga organet gjyqësore.

Avokati i Popullit vlerëson se nga të dhënat e administruara shtetasi M.S., në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se është marrë apo ka qenë i implikuar në aktivitet kriminal, duke u mbështetur në ngjarjen e ndodhur në vitin 1990/1991.

Pra, në rastin konkret nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit gjatë procesit të verifikimit dhe përpilimit të vërtetimit të besueshmërisë të shtetasit S.S. nuk është

³ Neni 19 “Mbrojtja e nevojshme” i Kodit Penal parashikon se:

“Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qenë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit me kusht që, karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit. Mospërputhja haptazi ndërmjet tyre përbën kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”.

administruar asnjë provë, për të vërtetuar informacionin se babai i tij është përfshirë në veprimtari kriminale. Në këto kushte, akti i nxjerrë nga strukturat e Policisë së Shtetit vjen në kundërshtim me nenin 81 “Vlerësimi i provave” të K.Pr.A., i cili parashikon se:

“Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ”.

Referuar kësaj dispozite rezulton që strukturat vendimmarrëse të procesit të verifikimit të besueshmërisë së shtetasit S.S. nuk kanë mundur/arritur të administrojnë qoftë edhe një provë të vetme, ndonëse kjo dispozitë kërkon më shumë se një provë kur përcakton *“të gjitha provave së bashku”*. Mungesa e këtyre provave për të vërtetuar veprimtarinë kriminale të babait të tij, nga strukturat e Policisë së Shtetit, ndonëse ky organ ka barrën e provës për të vërtetuar informacionin e administruar në ngarkim të tij, e bën aktin administrativ, vërtetimin e besueshmërisë, të nxjerrë ndaj ankuesit të kundërligjshëm.

Sjellim në vëmendje se barra e provës për të provuar ligjshmërinë e akteve administrative gjen mbështetje në nenin 82/1 të Kodit të Procedurës Administrative i cili parashikon se: *“1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, ...”*, si dhe në nenin 35, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" të ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë”.

Përdorimi i arsytimit se babai i ankuesit ka qënë i implikuar në aktivitet kriminal duke u bazuar në një informacion të pakonfirmuar me fakte shkresore e zyrtare të institucioneve kompetente, ndërkohë që ai nuk është dënuar nga gjykata për asnjë veprë penale, si dhe nuk ekziston asnjë provë konkrete ligjore për të provuar një fakt të tillë, krijon bindjen se skualifikimi i shtetasit S.S. nga Akademia e Sigurisë është bërë pa patur asnjë shkak të justifikuar. Ky qëndrim është rrjedhojë e mos kuptimit dhe mos zbatimit korrekt të nenit 30 të Kushtetutës, të nenit 19 të Kodit Penal dhe të akteve të tjera normative që rregullojnë fazën e fundit të verifikimit përfundimtar të aplikantëve për pranimin në Akademinë e Sigurisë dhe hartimin e vërtetimit të besueshmërisë së tyre.

Nga analizimi i fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se ndaj ankuesit është bërë një trajtim i padrejtë dhe disfavorizues nga DVP Durrës, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe i është cenuar e drejta e barazisë para ligjit dhe e drejta për arsimin, të garantuara nga nenet 18/1 dhe 57/1 të Kushtetutës.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, dhe në nenin 21/b, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;”*

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të nevojshme për rivlerësimin e vërtetimit të besueshmërisë të shtetasit S.S. në përputhje me ligjin, si dhe pranimin e tij në momentin më të parë dhe të përshtatshëm në Akademinë e Sigurisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi: S. Nushi